

VENDIM
Nr.318, datë 13.5.2005

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.787, DATË 26.11.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ZBATIMIN E FAZËS SË KATËRT TË NGUSHTIMIT TË
DIFERENCAVE NË MASËN E PENSIONEVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 88 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 4 të vendimit nr.787, datë 26.11.2003 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Në paragrafin e parë fjalët “... në periudhën nga 1.1.1997 deri më 30.6.2000” zëvendësohen me “... në periudhën nga 1.1.1997 deri më datë 31.12.1998”.

2. Në shkronjën “b”, fjalët “...në periudhën nga 1.2.1998 deri më 30.6.2000” zëvendësohen me “...në periudhën nga 1.2.1998 deri më 31.12.1998”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano